

UDHËZIM NR.14.1

Tranzicioni drejt ISO 14001:2026 – Informacion për klientët dhe organizatat e interesuara për certifikim

EQSC
European Quality & Safety Control

Rr: Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89/A, Kati 10, Nr. 35, Tiranë
Cel: +35569 60 87 402
www.eqsc-cert.org
info@eqsc-cert.org

Ky udhëzim ofron informacion dhe orientime të përgjithshme për tranzicionin nga standardi ISO 14001:2015 (përfshirë Amd 1:2024) në versionin e ri ISO 14001:2026. Ai synon të informojë organizatat e certifikuara nga EQSC, si dhe organizatat që aplikojnë për certifikim, mbi ndryshimet kryesore të standardit, afatet e tranzicionit dhe mënyrën se si do të realizohet procesi i kalimit drejt versionit të ri të standardit.

Dokumenti përshkruan veprimet që do të ndërmerren nga EQSC dhe pritshmëritë për organizatat e certifikuara gjatë kësaj periudhe, me qëllim sigurimin e një tranzicioni të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të certifikimit, përfshirë Global ACI-TECH-3-TR dhe udhëzuesin DA-IN-013 të DPA.



1. Hyrje

European Quality and Safety Control (EQSC) SHPK, si trupë certifikuese e akreditуar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) për certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor sipas standardit ISO 14001, është e angazhuar të sigurojë përputhshmëri të vazhdueshme me kërkesat e akreditimit dhe standardet ndërkombëtare përkatëse.

Publikimi i standardit **ISO 14001:2026** në prill 2026, i cili zëvendëson versionin e mëparshëm ISO 14001:2015 dhe Amendamentin ISO 14001:2015/Amd 1:2024, përcakton kërkesa të përditësuara për organizatat që zbatojnë sisteme të menaxhimit mjedisor dhe për trupat certifikuese që kryejnë auditime dhe certifikime të këtyre sistemeve.

Procesi i tranzicionit drejt versionit të ri të standardit realizohet në përputhje me kërkesat e ISO/IEC 17021-1, dokumentin e detyrueshëm të Global Accreditation Cooperation **Global ACI-TECH-3-TR 2029-04-30 (M)** dhe udhëzuesin e DPA **DA-IN-013**.

Ky udhëzim është përgatitur për të informuar organizatat e certifikuara nga EQSC, si dhe organizatat që aplikojnë për certifikim, mbi ndryshimet kryesore të standardit ISO 14001:2026, afatet e tranzicionit dhe mënyrën se si do të realizohet procesi i kalimit drejt versionit të ri të standardit.

EQSC i ka njoftuar klientët e saj të certifikuar sipas ISO 14001 për publikimin e standardit të ri gjatë auditimeve të kryera dhe do të vazhdojë t'i informojë gjatë çdo auditimi deri në përfundimin e periudhës së tranzicionit.

2. Fusha e Zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për organizatat e certifikuara nga European Quality and Safety Control (EQSC) SHPK sipas standardit ISO 14001:2015 (përfshirë Amd 1:2024), si dhe për organizatat që aplikojnë për certifikim sipas ISO 14001.

Dokumenti përshkruan mënyrën se si do të realizohet tranzicioni nga ISO 14001:2015 në ISO 14001:2026, duke përfshirë afatet e tranzicionit, mënyrën e kryerjes së auditimeve të tranzicionit dhe pritshmëritë për organizatat gjatë këtij procesi.

Ky udhëzim zbatohet për të gjitha auditimet e kryera nga EQSC në kuadër të procesit të certifikimit të sistemeve të menaxhimit mjedisor, duke përfshirë auditimet e certifikimit fillestar, auditimet mbikëqyrëse dhe auditimet e ricertifikimit, gjatë periudhës së tranzicionit drejt ISO 14001:2026.

© 2026 EQSC | Auditim & Certifikim ✅ | Menaxhim Mjedisor 🌐 | Qëndrueshmëri 🌳 | Siguri 🔒 | Integritet & Besueshmëri 🛡️



3. Referenca Normative

- **ISO 14001:2015**
  Sistemet e menaxhimit mjedisor — Kërkesat me udhëzime për përdorim

- **ISO 14001:2015/Amd 1:2024**
  Sistemet e menaxhimit mjedisor — Kërkesat me udhëzime për përdorim
  Ndryshimi 1: Ndryshimet lidhur me veprimin për klimën

- **ISO 14001:2026**
  Sistemet e menaxhimit mjedisor — Kërkesat me udhëzime për përdorim

- **ISO/IEC 17021-1:2015**
  Vlerësimi i përputhshmërisë — Kërkesat për trupat që ofrojnë auditim dhe certifikim të sistemeve të menaxhimit — Pjesa 1: Kërkesat

- **Global ACI-TECH-3-TR 2029-04-30 (M)**
  Transition Requirements for ISO 14001:2026

- **DA-IN-013 V.0, 10.09.2026**
  Udhëzues për kalimin nga standardi ISO 14001:2015 përfshirë Amd 1:2024 në ISO 14001:2026 (DPA)

4. Statusi i Zbatimit dhe Tranzicioni

Ky udhëzim përcakton mënyrën se si do të menaxhohet tranzicioni drejt standardit ISO 14001:2026 për organizatat e certifikuara dhe për organizatat që aplikojnë për certifikim.

EQSC është përgatitur për standardin e ri: dokumentacioni i saj është rishikuar në përputhje me ISO 14001:2026 dhe i gjithë stafi i përfshirë në procesin e certifikimit është trajnuar mbi kërkesat e reja të standardit.

EQSC do të kryejë auditime tranzicioni dhe do të lëshojë certifikata të akredituara sipas ISO 14001:2026 pas marrjes së vendimit të tranzicionit nga trupi i akreditimit DPA, në përputhje me

© 2026 EQSC | Auditim & Certifikim ✅ | Menaxhim Mjedisor 🌐 | Qëndrueshmëri 🌱 | Siguri 🔒 | Integritet & Besueshmëri 🛡️



afatet e përcaktuara nga Global ACI dhe DPA. Deri në atë moment, EQSC vazhdon të kryejë auditime dhe certifikime sipas ISO 14001:2015 (përfshirë Amd 1:2024).

5. Periudha e Tranzicionit dhe Afatet Kohore

ISO 14001:2026 është publikuar në **prill 2026** dhe periudha e tranzicionit është përcaktuar **36 muaj (3 vite)**, me përfundim më **30 Prill 2029**.

Afati	Çfarë do të thotë për organizatën tuaj
Deri më 30 Prill 2027	EQSC përfundon procesin e tranzicionit të akreditimit pranë DPA. Pas vendimit të DPA, EQSC fillon auditimet e tranzicionit dhe lëshimin e certifikatave sipas ISO 14001:2026.
31 Tetor 2027	Nga kjo datë, certifikimet e reja fillestare dhe ricertifikimet kryhen vetëm sipas ISO 14001:2026.
30 Prill 2029	Përfundon periudha e tranzicionit. Certifikatat sipas ISO 14001:2015 (përfshirë Amd 1:2024) nuk do të jenë më të vlefshme.

- Klientët e EQSC të certifikuar aktualisht sipas ISO 14001:2015 duhet të kryejnë tranzicionin drejt ISO 14001:2026 brenda kësaj periudhe tranzicioni.
- Tranzicioni kryhet zakonisht gjatë auditimit mbikëqyrës ose auditimit të ricertifikimit, ose, me kërkesë të klientit, nëpërmjet një auditimi të veçantë tranzicioni.
- Kur tranzicioni kryhet gjatë auditimit mbikëqyrës, certifikata e re sipas ISO 14001:2026 ruan datën e skadencës së ciklit aktual të certifikimit; kur kryhet gjatë ricertifikimit, fillon një cikël i ri trevjeçar.
- Pas datës 30 Prill 2029, certifikatat sipas ISO 14001:2015 nuk do të jenë më të vlefshme, pavarësisht datës së shënuar në to.

6. Ndryshimet kryesore nga ISO 14001:2015 në ISO 14001:2026

Standardi ISO 14001:2026 ruan strukturën bazë të versionit 2015. Ndryshimet konsiderohen të moderuara dhe nuk kërkojnë rindërtimin e sistemit ekzistues, por organizatat duhet t'i analizojnë dhe t'i zbatojnë ato në mënyrë të dokumentuar.

Ndryshimet kryesore përfshijnë:

- **Struktura e harmonizuar** – Standardi është përafruar me versionin e fundit të Strukturës së Harmonizuar të ISO për sistemet e menaxhimit (Annex SL), përfshirë termat dhe përkufizimet, duke lehtësuar integrimin me ISO 9001, ISO 45001 dhe standarde të tjera.

© 2026 EQSC | Auditim & Certifikim ✅ | Menaxhim Mjedisor 🌐 | Qëndrueshmëri | Siguri 🔒 | Integritet & Besueshmëri



- **Informacioni i dokumentuar** – Është sqaruar kërkesa që informacioni i dokumentuar "duhet të jetë i disponueshëm".
- **Ndryshimet klimatike** – Kërkesat e Amendamentit 1:2024 janë integruar në standard. Organizata duhet të përcaktojë nëse ndryshimet klimatike janë çështje e rëndësishme për sistemin e saj të menaxhimit mjedisor dhe nëse palët e interesuara kanë kërkesa që lidhen me klimën.
- **Konteksti dhe kushtet mjedisore** – Organizata duhet të marrë në konsideratë kushtet mjedisore si nivelet e ndotjes, disponueshmërinë e burimeve natyrore, ndryshimet klimatike, biodiversitetin dhe shëndetin e ekosistemeve.
- **Lidershipi** – Theksohet roli aktiv i drejtimit të lartë në mbështetjen e të gjitha roleve përkatëse në organizatë.
- **Rreziqet dhe mundësitë** – Planifikimi i rreziqeve dhe mundësive është ristrukturuar dhe sqaruar, duke i dalluar më qartë nga aspektet mjedisore dhe detyrimet për përputhshmërinë.
- **Planifikimi i ndryshimeve** – Është shtuar një kërkesë e re që organizata të planifikojë dhe kontrollojë ndryshimet që ndikojnë në sistemin e menaxhimit mjedisor.
- **Ofruesit e jashtëm dhe cikli i jetës** – Kontrolli operacional shtrihet te proceset, produktet dhe shërbimet e ofruara nga jashtë, me theks më të fortë në perspektivën e ciklit të jetës.
- **Auditimi i brendshëm** – Programi i auditimit të brendshëm duhet të përcaktojë edhe objektivat e çdo auditimi.
- **Rishikimi nga drejtimi** – Janë shtuar nën-klauzola të reja te klauzola 9.3, të cilat duhet të reflektohen në rishikimin nga drejtimi.

Këto ndryshime synojnë të forcojnë efektivitetin e sistemeve të menaxhimit mjedisor dhe të mbështesin organizatat në përmirësimin e performancës së tyre mjedisore.

7. Veprimet e klientëve të EQSC për tranzicionin sipas ISO 14001:2026

Organizatat që aktualisht janë të certifikuara sipas ISO 14001:2015 duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor me kërkesat e standardit të ri ISO 14001:2026 brenda periudhës së tranzicionit.

Në këtë kuadër, organizatat e certifikuara duhet të marrin në konsideratë veprimet e mëposhtme:

- **Njohja me kërkesat e standardit të ri** – Organizata duhet të sigurojë standardin ISO 14001:2026 dhe të identifikojë ndryshimet kryesore krahasuar me versionin 2015.
- **Kryerja e një analize të boshllëqeve (gap analysis)** – Rekomandohet të kryhet një vlerësim i sistemit ekzistues për të identifikuar diferencat midis praktikave aktuale dhe kërkesave të standardit të ri.

© 2026 EQSC | Auditim & Certifikim ✅ | Menaxhim Mjedisor 🌐 | Qëndrueshmëri 🌳 | Siguri 🔒 | Integritet & Besueshmëri 🛡️



- **Përditësimi i sistemit të menaxhimit mjedisor** – Në bazë të analizës, organizata duhet të përditësojë analizën e kontekstit, palët e interesuara, rreziqet dhe mundësitë, procesin e menaxhimit të ndryshimeve, kontrollet ndaj ofruesve të jashtëm dhe informacionin e dokumentuar.
- **Trajnimi dhe ndërgjegjësimi i personelit** – Personeli përkatës duhet të informohet dhe të trajnohet mbi ndryshimet e standardit dhe përditësimet e bëra në sistem.
- **Kryerja e auditimit të brendshëm dhe rishikimit nga drejtimi** – Para auditimit të tranzicionit, organizata duhet të sigurojë që sistemi i përditësuar është vlerësuar përmes auditimit të brendshëm dhe rishikimit nga drejtimi sipas ISO 14001:2026.
- **Planifikimi i auditimit të tranzicionit me EQSC** – Organizata duhet të koordinohet me EQSC për planifikimin e auditimit të tranzicionit, i cili zakonisht kryhet gjatë një auditimi mbikëqyrës ose të ricertifikimit dhe kërkon kohë shtesë auditimi.

Auditimi i tranzicionit nuk kufizohet në rishikimin e dokumenteve: auditorët e EQSC do të verifikojnë zbatimin dhe efektivitetin e kërkesave të reja në praktikë. Mospërputhjet e identifikuara duhet të mbyllen përpara marrjes së vendimit të tranzicionit.

Koha e auditimit të tranzicionit: në përputhje me kërkesat e Global ACI, EQSC e ka përcaktuar kohën e auditimit të tranzicionit si më poshtë:

- Auditimi i tranzicionit gjatë auditimit mbikëqyrës ose të ricertifikimit – **0.5 ditë** shtesë në kohën normale të auditimit;
- Auditim i veçantë tranzicioni – **1 ditë**;
- Certifikim fillestar sipas ISO 14001:2026 – koha normale e auditimit, pa kohë shtesë.

Për klientët ekzistues, kostoja e auditimit të tranzicionit përfshihet brenda ofertës ekzistuese dhe nuk kërkohet rishikim i saj.

EQSC do të mbështesë klientët e saj gjatë kësaj periudhe tranzicioni duke ofruar informacion dhe orientime të përgjithshme mbi kërkesat e standardit dhe procesin e certifikimit, pa ofruar konsulencë, në përputhje me kërkesat e paanshmërisë.

Organizatat që zgjedhin të mos kalojnë në versionin e ri mund të vazhdojnë të auditohen sipas ISO 14001:2015, por certifikata e tyre do të jetë e vlefshme vetëm deri më **30 Prill 2029**.

© 2026 EQSC | Auditim & Certifikim ✅ | Menaxhim Mjedisor 🌐 | Qëndrueshmëri | Siguri 🔒 | Integritet & Besueshmëri



8. Veprimet që duhet të ndërmarrin organizatat që duan të certifikohen sipas ISO 14001

Organizatat që synojnë të marrin certifikimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor nga EQSC duhet të ndërmarrin veprimet e mëposhtme për të garantuar një proces të suksesshëm dhe në përputhje me kërkesat e standardit ISO 14001:2026:

- **Njohja me kërkesat e ISO 14001:2026** – Organizata duhet të analizojë kërkesat e standardit të ri dhe udhëzimet e EQSC për certifikimin.
- **Kryerja e një vlerësimi paraprak (gap analysis)** – Organizata duhet të identifikojë boshllëqet midis praktikave ekzistuese dhe kërkesave të standardit, duke përgatitur një plan veprimi.
- **Ngritja ose përditësimi i sistemit** – Politika mjedisore, aspektet mjedisore, detyrimet për përputhshmërinë, rreziqet dhe mundësitë, kontrolli operacional dhe informacioni i dokumentuar duhet të harmonizohen me kërkesat e ISO 14001:2026.
- **Trajnimi i personelit dhe ndërgjegjësimi** – Personeli përgjegjës duhet të trajnohet mbi standardin e ri dhe përgjegjësitë e tij.
- **Auditimi i brendshëm dhe rishikimi nga drejtimi** – Organizata duhet të vlerësojë sistemin e saj përpara auditimit nga EQSC.
- **Aplikimi për certifikim tek EQSC** – Organizatat aplikojnë tek EQSC dhe planifikojnë auditimin sipas procedurave të certifikimit.

Afatet e rëndësishme:

- **Deri në vendimin e DPA për tranzicionin e EQSC** – Organizatat mund të certifikohen sipas ISO 14001:2015, por certifikata do të jetë e vlefshme deri më 30 Prill 2029 dhe do të kërkojë auditim tranzicioni.
- **Pas vendimit të DPA** – EQSC rekomandon që aplikimet e reja të bëhen drejtpërdrejt sipas ISO 14001:2026.
- **Pas 31 Tetor 2027** – Çdo certifikim i ri fillestar kryhet vetëm sipas ISO 14001:2026.

EQSC do të sigurojë informacion dhe udhëzime gjatë gjithë procesit të certifikimit, për të garantuar që organizatat të arrijnë përputhshmërinë me standardin e ri dhe të përfitojnë certifikatën në mënyrë të besueshme dhe të dokumentuar.

© 2026 EQSC | Auditim & Certifikim ✅ | Menaxhim Mjedisor 🌐 | Qëndrueshmëri 🌱 | Siguri 🔒 | Integritet & Besueshmëri 🛡️



🎯 Thirrje për veprim

European Quality and Safety Control (EQSC) ju fton të rishikoni sistemin tuaj të menaxhimit në përputhje me ISO 14001:2026 dhe të planifikoni tranzicionin ose certifikimin fillestar.

📩 Na kontaktoni:
[📞 +355696087402] | [✉️ info@eqsc-cert.org] | [🌐 www.eqsc-cert.org]

© 2026 EQSC | Auditim & Certifikim ✅ | Menaxhim Mjedisor 🌐 | Qëndrueshmëri 🌱 | Siguri 🔒 | Integritet & Besueshmëri 🛡️